



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit / Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta
/ Ministry of Culture, Youth and Sports

Prishtinë, Mars 2022

THIRRJA PËR PROJEKT-PROPOZIMET KULTURORE 2022

ART DHE TRASHËGIMI KULTURORE

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore për vitin 2022 renditë ndër prioritetet programore fuqizimin e rolit të skenës së pavarur kulturore në zhvillimin dhe zbatimin e politikave publike, rritjen e cilësisë së krijimtarisë artistike, identifikimin dhe mbështetjen e talentëve të rinj, aktivizimin e të rinjve në vendimmarrje dhe aktivitete të fushës së artit dhe trashëgimisë kulturore, rrjetëzimin dhe promovimin e produktit vendor kulturor si produkt konkurrues në tregun ndërkombëtar të industrisë kreative.

Në funksion të prioritetit programor, thirrja për projekt-propozimet kulturore për vitin 2022 që mbulon fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore synon mbështetjen e projekt-propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve që zhvillohen në Republikën e Kosovës apo në shtetet e tjera, të cilët përmbushin objektivat e përgjithshme si në vijim:

- Promovimi i artit dhe trashëgimisë kulturore përmes pasurimit, diversifikimit dhe rritjes së cilësisë së jetës kulturore;
- Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve në jetën kulturore brenda dhe jashtë Republikës së Kosovës, me theks tek fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara;
- Fuqizimi i koordinimit dhe partneritetit ndërmjet institucioneve të kulturës dhe trashëgimisë kulturore dhe shoqërisë civile përmes fuqizimit të skenës së pavarur kulturore dhe nxitjes së akterëve të rinj që veprojnë në fushën e kulturës;
- Promovimi i artit dhe trashëgimisë kulturore përmes zhvillimit të diplomacisë publike.

Projekt-propozimet e zhvilluara në përputhje me objektivat e përgjithshme dhe specifike duhet të synojnë gjithëpërfshirjen duke siguruar përfshirjen aktive të grupeve të ndryshme të komunitetit në aktivitetet përkatëse të projekt-propozimit, në veçanti të rinjtë, të moshuarit, vajzat dhe gratë, personat me aftësi të kufizuara, komunitetin LGBTIQ, komunitetet pakicë, etj.

Të drejtë aplikimi me projekt-propozime në thirrjen publike për vitin 2022 kanë OJQ-të dhe Individët që dëshmojnë se programi i tyre i punës është i profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore. OJQ-të dhe Individët mund të aplikojnë në njëren nga kategoritë në vijim:

- 1. Mbështetje për zhvillimin organizativ dhe programor të OJQ-ve të artit dhe trashëgimisë kulturore;**
- 2. Ngjarjet tradicionale të artit dhe trashëgimisë kulturore;**
- 3. Projektet dhe ngjarjet në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;**
- 4. Projektet e krijuesve (artistëve) të rinj;**
- 5. Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Kosovës.**

OJQ-të dhe individët mund të aplikojnë me më së shumti 1 projekt-propozim në një nga katër kategoritë e para (kategoria 1, 2, 3 dhe 4) të kësaj thirrje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5, për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategoritë 1, 2, 3 dhe 4.

Pesë kategoritë e listuara më sipër janë elaboruar më poshtë, duke zbërthyer synimet dhe aktivitetet përkatëse, fushëveprimin, kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për aplikuesit, si dhe shkallën maksimale dhe minimale të mbështetjes.

Vlerësimi i projekt-propozimeve do të zhvillohet në dy faza:

Vlerësimi administrativ, që identifikon nëse aplikuesi ka ofruar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse. Plotësimi i dokumentacionit pas afatit të aplikimit, përkatësisht gjatë periudhës së vlerësimit apo afatit të ankesave, nuk është i mundshëm.

Vlerësimi përmbajtësor, që vlerëson

- Nëse aplikuesi është i profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Nëse aplikuesi ka respektuar parimet e qeverisjes së mirë në zbatimin e programit përkatës në vitet paraprake;
- Nëse aplikuesi ka paraparë respektimin e parimeve të qeverisjes së mirë në zbatimin e projekt-propozimit të paraqitur në këtë thirrje publike;
- Nëse aplikuesi posedon kapacitete profesionale dhe teknike për të zbatuar aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;
- Nëse është përcaktuar ekipi i projekt-propozimit dhe detyrimet e anëtarëve të ekipit;
- Nëse projekt-propozimi përputhet me fushëveprimin e kësaj thirrje publike;
- Nëse projekt-propozimi kontribuon në përmbushjen e objektivave të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse;
- Nëse aktivitetet e projekt-propozimit janë të qarta, të arsyeshme, të kuptueshme dhe të zbatueshme;

- Nëse kostot e projekt-propozimit janë reale karshi rezultateve specifike dhe kohëzgjatjes së pritshme të projekt-propozimit;
- Nëse kostot e projekt-propozimit janë në përputhje me aktivitetet e planifikuara të projekt-propozimit;

Në rast të dështimit për të përmbushur ndonjërin nga kriteret e përgjithshme apo të veçanta të përcaktuara me këtë thirrje publike për kategoritë përkatëse, aplikacioni do të konsiderohet i pa kompletuar dhe si i tillë nuk do të kualifikohet për mbështetje financiare.

Aplikimi:

OJQ-të dhe individët duhet të aplikojnë në thirrje publike për projekt-propozimet kulturore 2022 vetëm përmes platformës online e-Kosova. Projekt-propozimet e shtypura në formë fizike nuk do të pranohen për shqyrtim.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit mbetet e përkushtuar në avancimin e shërbimeve për komunitetin artistik brenda dhe jashtë kufinjve të Republikës së Kosovës.

Për të aplikuar përmes platformës online, duhet të ndiqen këto hapa:

- Në platformën Ekosova, si dhe udhëzimet për regjistrim në platformë. kliko: <https://ekosova.rks-gov.net/> , pastaj:
- - Për të shkarkuar udhëzuesin për aplikim online për projekt-propozimet kulturore për 2022 për OJQ kliko këtu: **Udhëzues per Aplikim Online - OJQ**
 - Për të shkarkuar udhëzuesin për aplikim online për projekt-propozimet kulturore për 2022 për Individ kliko këtu: **Udhëzues per Aplikim Online - Individë**
 - Për të shkarkuar udhëzimet për aplikuesit sa i përket procesit të pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimit, dhënies së fondeve, kohës dhe mënyrës së parashtrimit të ankesave, trajtimit të dokumenteve dhe kalendarit tregues të zbatimit të thirrjes, kliko këtu:
 - OJQ
 - **RREGULLORE MF - NR - 04/2017 MBI KRITERET, STANDARDET DHE DHE PROCEDURAT E FINANCIMIT PUBLIK TË OJQ-VE**
 - Individë
 - **Rregullore (MKRS) – NR 09/2015 Për Subvencionimin në Fushën e Kulturës, Trashëgimisë Kulturore, Rinisë dhe Sportit**

Afati për aplikim:

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projekt-propozimet që janë pranuar brenda afatit të paraparë, të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara me këtë thirrje publike. Afati i fundit për aplikim është 15 ditë pune nga dita e shpalljes së kësaj thirrje publike dhe përfundon me datën: **22 prill 2022, në ora 23:59.**

Më shumë informacione rreth thirrjes publike:

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: jehona.shyti@rks-gov.net; vjollca.aliu@rks-gov.net;

Më shumë informacione rreth platformës online të aplikimit:

Të gjitha çështjet teknike që lidhen me platformën elektronike për aplikim në thirrjen publike për projekt-propozime kulturore 2022 mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: shkelzen.nuza@rks-gov.net;

KATEGORIA E PARË:

Mbështetje për zhvillim organizativ dhe programor të OJQ-ve të Artit dhe Trashëgimisë Kulturore

Synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është fuqizimi i skenës së pavarur kulturore duke ndërtuar një mjedis të përshtatshëm ligjor që lehtëson zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të bazuar në parimet e qeverisjes së mirë, duke ofruar instrumente financiare të përshtatshme dhe lehtë të qasshme që sigurojnë transparencë dhe korrektësi, duke lehtësuar qasjen në tregun ndërkombëtar të industrisë kreative, dhe duke nxitur një koordinim dhe bashkëpunim të mirëfilltë ndërmjet akterëve në këtë fushë.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e OJQ-ve të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, të cilat janë të organizuara mirë, kanë vizion të qartë dhe strategji konkrete e të qartë të veprimit, kanë kontribuar në zhvillimin e sektorit të kulturës në Republikën e Kosovës dhe kanë dëshmuar kapacitet profesional dhe teknik për zbatimin e strategjisë së tyre. Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për zhvillim organizativ dhe programor, synohet:

- 1.1. Fuqizimi i skenës së pavarur kulturore përmes zhvillimit të organizatave të dëshmuara të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- 1.2. Rritja e cilësisë së krijimtarisë artistike;
- 1.3. Fuqizimi i partneritetit në mes të institucioneve publike dhe komunitetit kulturor në zhvillimin dhe zbatimin e politikave adekuate publike për fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- 1.4. Zhvillimi i diplomacisë publike përmes rritjes së cilësisë së aktiviteteve artistike dhe të trashëgimisë kulturore të cilët prezantohen në sferën ndërkombëtare, dhe përmes përfshirjes në rrjetet ndërkombëtare të organizatave të kulturës;
- 1.5. Shkëmbimi i njohurive dhe ngritja e vetëdijes rreth rolit të artit dhe trashëgimisë kulturore tek qytetarët, me theks të veçantë tek fëmijët;
- 1.6. Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;

1.7. Përmirësimi i kushteve të përshtatshme të operimit të akterëve kyç të skenës së pavarur kulturore, përfshirë këtu hapësirën operuese për ushtrim të veprimtarisë së tyre, kapacitetin e nevojshëm njerëzor menaxhues dhe profesional.

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Në këtë pikë për këtë cikël të thirrje publike për projekt-propozimet kulturore 2022 përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021)*
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike *“Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës”* për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategorinë 1;
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike *“Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës”* për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategorinë 1;
- Nëse projekt-propozimet kanë të bëjnë me ndërhyrje/aktivite në asete të trashëgimisë kulturore, duhet të ofrohet leja (aprovimi) nga organi kompetent, ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në programe dhe aktivitete artistike dhe të trashëgimisë kulturore;
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e artit dhe/apo trashëgimisë kulturore gjatë 4 viteve të fundit;
- Të ofrojnë Strategjinë e Organizatës, me vlefshmëri të paktën për dy vitet e ardhshme;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore - CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);
- Të ofrojnë pasqyrat financiare për 4 vitet e fundit, përkatësisht vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021. Shuma mesatare e qarkullimit vjetor për vitet paraprake (2018-2021) duhet të jetë së paku dyfishi i shumës së aplikimit në këtë thirrje publike. *(Për shkak të rrethanave të krijuara nga pandemia, viti 2020 mund të përjashtohet nga vlerësimi).*
- Të dëshmojnë menaxhim të përgjegjshëm financiar të projekteve dhe programeve përmes paraqitjes së raporteve të auditimit të jashtëm të OJQ-së për 4 vitet e fundit;
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm dhe Vlerësimit të ndikimit social dhe ekonomik të programit vjetor të OJQ-së në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike;
- Të integrojnë komponentën e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve rreth artit dhe/apo trashëgimisë kulturore në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- | | |
|---|-----------------|
| • Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues | 100,000.00 Euro |
| • Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues | 50,000.00 Euro |

KATEGORIA E DYTË:

Ngjarjet tradicionale të artit dhe trashëgimisë kulturore

Synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është gjallërimi dhe begatimi i jetës kulturore, si dhe nxitja e promovimi i diversitetit kulturor përmes mbështetjes së ngjarjeve të mëdha e gjithëpërfshirëse kulturore në Republikën e Kosovës.

Kjo kategori synon mbështetjen e organizimeve tradicionale (vjetore ose bienale) në territorin e Kosovës që organizohen nga OJQ-të e profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, duke mbështetur veprimtaritë të cilat bazohen në shprehje krijuese artistike bashkëkohore, individuale apo grupe, si dhe ato që kultivojnë dhe promovojnë traditat dhe vlerat e trashëgimisë së pasur kulturore, të tilla si festivalet e muzikës, filmit, teatrit, artit pamor, artet skenike, panairët, bienalet etj. Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për ngjarjet tradicionale të artit dhe trashëgimisë kulturore, synohet:

- 2.1 Ngritja e cilësisë së krijimtarisë artistike dhe organizimeve kulturore në Republikën e Kosovës;
- 2.2 Zhvillimi i diplomacisë publike përmes shkëmbimit të përvojave me komunitetin ndërkombëtar artistik dhe të trashëgimisë kulturore si pjesë e integruar e ngjarjeve kulturore;
- 2.3 Nxitja e turizmit kulturor si formë e kontributit në rritjen lokale ekonomike të vendbanimeve;
- 2.4 Promovimi i trashëgimisë shpirtërore të të gjitha komuniteteve në Republikën e Kosovës;
- 2.5 Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore.

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);

- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Në këtë pikë për këtë cikël të thirrje publike për projekt-propozimet kulturore 2022 përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021)*
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike *“Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës”* për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategorinë 2;
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike *“Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës”* për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategoritë 2;
- Nëse projekt-propozimet kanë të bëjnë me ndërhyrje/aktivite në asete të trashëgimisë kulturore, duhet të ofrohet leja (aprovimi) nga organi kompetent, ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve artistike dhe të trashëgimisë kulturore;
- Të ofrojnë portfolio me dëshmi të mbarëvajtjes së aktiviteteve tradicionale në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore së paku 5 vite me radhë;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (dëshmi mbi skemën organizative, kapacitetet njerëzore - CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);
- Të ofrohet pasqyra e ndikimit ekonomik dhe social gjatë viteve paraprake. Raporti duhet të mbajë të paktën të dhëna rreth numrit të artistëve ndërkombëtar pjesëmarrës, numrit të artistëve vendorë pjesëmarrës, numrit të vullnetarëve, numrit të vizitorëve vendor, numrit të vizitorëve ndërkombëtar, etj. Inkurajohet ofrimi i dëshmimeve mbi ndikimin socio-ekonomik dhe vlerësimet ndërkombëtare mbi cilësinë e organizimit/ngjarjes gjatë viteve paraprake ;
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike;
- Të integrojnë komponentën e edukimit të fëmijëve dhe të rinjve rreth artit dhe/apo trashëgimisë kulturore në projekt-propozimin përkatës.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfutuese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 35,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 25,000.00 Euro

KATEGORIA E TRETË:

Projektet dhe ngjarjet në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore

Ministria së Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon të nxisë ndërlydhjen e ngushtë ndërmjet ruajtjes, dokumentimit dhe zhvillimit të artit e trashëgimisë kulturore në njërin anë, dhe integrimin e artit dhe trashëgimisë kulturore në politikat zhvillimore për një mirëqenie të avancuar sociale dhe ekonomike.

Në këtë kategori parashihet mbështetja e projekt-propozimeve të OJQ-ve dhe Individëve të profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me synim:

3.1 Promovimi, pasurimi dhe diversifikimi i jetës kulturore përmes aktiviteteve gjithëpërfshirëse në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:

- Shënimi i Ditëve Ndërkombëtare Kulturore dhe të Trashëgimisë Kulturore;
- Organizimi i fushatave të vetëdijesimit rreth zbatimit të politikave publike;
- Promovimi i dijeve tradicionale - transferim i kujtesës kolektive dhe rrëfimeve gojore te brezat e rinj;
- Promovimi i diversitetit kulturor të Kosovës, duke nxitur vullnetarizmin dhe pjesëmarrjen aktive të të rinjve nga zona dhe komunitete të ndryshme etnike në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Aktivizimi i grupeve të nënpërfaqësuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me theks të veçantë personat me aftësi të kufizuara dhe personat e moshuar;
- Organizimi i ditëve të diasporës përmes aktiviteteve të përbashkëta të artistëve vendor dhe jashtë vendit;
- Organizimi i ngjarjeve kulturore në përputhje me kalendarin e aktiviteteve “Viti i personave me aftësi të kufizuara”;
- Të tjera.

3.2 Zhvillimi i hulumtimit, dokumentimit dhe kualifikimit profesional në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:

- Zhvillimi i hulumtimeve, kërkimeve dhe prezantimeve në medime të ndryshme të artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Rritja e mbështetjes për autorët dhe botuesit (botim dhe përkthim i librave);
- Prezantimi dhe botimi i gjetjeve dhe arritjeve kërkimore në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Organizimi i kampeve të restaurimit për lokalitetet e trashëgimisë kulturore duke i synuar të rinjtë, mjeshtrit dhe pronarët;
- Organizimi i konferencave, simpoziumeve dhe tryezave hulumtuese;
- Të tjera.

3.3 Edukimi joformal i gjeneratave të reja rreth artit dhe trashëgimisë kulturore. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:

- Zhvillimi i programeve joformale për pjesëmarrje të rregullt të nxënësve dhe të rinjve në ngjarje kulturore;
- Zhvillimi i programeve të edukimit joformal për përfshirje të artit dhe trashëgimisë kulturore në programe mësimore;
- Zhvillimi dhe menaxhimi i sistemeve digjitale për mbledhjen, arkivimin dhe menaxhimin e të dhënave në sektorin e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Të tjera.

3.4 Zhvillimi i turizmit kulturor. Aktivitetet specifike që jetësojnë këtë synim mund të konsiderohen:

- Funksionalizimi i monumenteve në funksion të industrisë së turizmit;
- Promovimi i gastronomisë lokale tradicionale si prodhim turistik;
- Promovimi ndërkombëtar i turizmit vendor kulturor;
- Të tjera.

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës apo në shtetet ku është e koncentruar diaspora, të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Individët shtetas të Republikës së Kosovës apo shtetas të huaj pjesëtarë të diasporës kosovare, të profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora sipas legjislacionit ekuivalent për regjistrimin e organizatave jo-për-përfitim në vendin përkatës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës, përkatësisht dokumentacionin ekuivalent sipas legjislacionit të shtetit përkatës për OJQ-të e diasporës të regjistruara në vendin e huaj;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e

aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Në këtë pikë për këtë cikël të thirrje publike për projekt-propozimet kulturore 2022 përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021)*
- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike *“Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës”* për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategorinë 3;
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike *“Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës”* për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategorinë 3;
- Nëse projekt-propozimet kanë të bëjnë me ndërhyrje/aktivite në asete të trashëgimisë kulturore, duhet të ofrohet leja (aprovimi) nga organi kompetent, ashtu siç parashihet me legjislacionin në fuqi.

Kriteret e veçanta për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të duhet të jenë të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve artistike dhe të trashëgimisë kulturore. **Në vlerësim mund të konsiderohet edhe përvoja individuale e anëtarëve të organizatës nëse OJQ-ja është e themeluar rishtazi**;
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e artit dhe/apo trashëgimisë kulturore gjatë të paktën 2 viteve të fundit;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (skema organizative, stafi-CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);
- Të ofrojnë pasqyrat financiare për të paktën 2 vitet e fundit, përkatësisht vitet 2020 dhe 2021;
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike.

Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- Nëse ka përfiturar më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me

rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. (Në këtë pikë për këtë cikël të thirrjes publike për projekt-propozimet kulturore 2022 përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021)

- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se një projekt-propozim në këtë thirrje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike "Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës" për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategorinë 3;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

Kriteret e veçanta për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Duhet të jenë të profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në organizim të aktiviteteve artistike dhe të trashëgimisë kulturore;
- Të ofrojnë portfolion me dëshmi të aktiviteteve në fushën e artit dhe/apo trashëgimisë kulturore gjatë 4 viteve të fundit;
- Të dëshmojnë kompetencë profesionale dhe teknike për zbatimin e projekt-propozimit (skema organizative, stafi-CV dhe diplomat përkatëse, hapësirat e punës, pajisjet teknologjike etj);
- Të ofrojnë dëshmi të qarkullimit vjetor financiar përmes pasqyrës financiare të projekt-propozimeve të zbatuara për 4 vitet e fundit, përkatësisht vitet 2018, 2019, 2020 dhe 2021;
- Të integrojnë zhvillimin e Auditimit të jashtëm të projektit në projekt-propozimin me të cilin aplikojnë në këtë thirrje publike

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 20,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 10,000.00 Euro

KATEGORIA E KATËRT:

Projektet e krijuesve (artistëve) të rinj

Synimi i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit është të nxisë krijimtarinë artistike të të rinjve të talentuar (artistë të rinj) në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore.

Kjo kategori synon mbështetjen e Individëve nga fusha e artit dhe trashëgimisë kulturore, në veçanti:

- Artin pamor, përfshirë instalacionet, pikturën, performancën artistike, fotografinë, skulpturën, grafikën, etj;
- Artin muzikor dhe vallëzimin;
- Artin skenik, përfshirë regjinë, monodramat, shkrimi i dramës, shfaqja taktike, etj.;
- Artin tradicional, përfshirë zanatet tradicionale;
- Artin letrar, përfshirë letërsinë artistike, poezinë, letërsinë për fëmijë, kritikën, gazetarinë, shkrimin rreth artit, etj.;
- Filmin;
- Multimedian;
- Të tjera.

Nëpërmjet ofrimit të mbështetjes së veçantë për krijuesit (artistët) e rinj synohet:

- Vazhdimësia e jetës artistike, bartja e traditave nga e kaluara në gjeneratat e reja;
- Pasurimi i shprehjes krijuese artistike bashkëkohore;
- Gjenerimi i kuadrove të reja profesionale, të cilët do të kontribuojnë në ngritjen e cilësisë profesionale në fushën e krijimtarisë artistike e kulturore;
- Nxitja e vullnetarizmit dhe pjesëmarrjes aktive të të rinjve dhe personave me aftësi të kufizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;

Kush mund të aplikojë:

- Individët (të rinjtë), studentë apo të sapo-diplomuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore në fakultetet përkatëse në Republikën e Kosovës.

Kriteret e përgjithshme minimale të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës apo në shtetin ku është e koncentruar diaspora;
- Nëse ka përfutur më parë mbështetje financiare publike, të ofrojë dëshmi se ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. *(Në këtë pikë për këtë cikël të thirrje publike për projekt-propozimet*

kulturore 2022 përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021)

- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos kenë aplikuar me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike *“Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës”* për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategorinë 4;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

Kriteret e veçanta të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jetë student/e apo i/e sapo-diplomuar në fushën e artit dhe/apo trashëgimisë kulturore;
- Të ofrojnë portfolion e punimeve;
- Të jenë të moshës deri 25 vjeç;

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 5,000.00 Euro
- Shuma minimale e mbështetjes për një përfitues 3,000.00 Euro

KATEGORIA E PESTË:

Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Kosovës

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit synon promovimin dhe prezantimin ndërkombëtar të produktit kulturor vendor dhe skenës së pavarur të Republikës së Kosovës nga fusha e artit dhe trashëgimisë kulturore, duke kontribuar në zhvillimin e diplomacisë publike.

Në këtë kategori të thirrjes publike parashihet mbështetja e nismave individuale dhe grupore, për pjesëmarrje në aktivitete që do të kontribuojnë në promovimin ndërkombëtar të artit vendor dhe trashëgimisë kulturore. Aktivitetet të cilët përfshihen në këtë kategori janë pjesëmarrja, prezantimi dhe/apo performim i akterëve/individëve dhe OJQ-ve në ngjarje ndërkombëtare duke përfshirë konferenca, festivale, panaire, koncerte, ekspozita etj. në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore.

Nëpërmjet kësaj kategorie mbështeten aktivitetet sikurse shpenzimet e udhëtimit, shërbime të transportit, akomodimi, mëditje, pagesë (taksë) regjistrimi për pjesëmarrje në platformat përkatëse, hapësirat e prezantimit (qiraja) dhe të ngjashme.

Kush mund të aplikojë:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Individët shtetas të Republikës së Kosovës, të profilizuar në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta.

Kriteret e përgjithshme minimale për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të jenë të regjistruar si OJQ sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi për lirinë e asociimit në organizata jo-qeveritare në Republikën e Kosovës;
- Të jenë të pajisur me numër fiskal sipas kërkesave të legjislacionit tatimor të Republikës së Kosovës;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete të projekt-propozimit respektiv;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;
- Të ofrojnë dëshmi se OJQ-ja nuk ka obligime tatimore (nga ATK);
- Të ofroj dëshmi se OJQ-ja ka kryer transaksionet financiare në mënyrë transparente sipas legjislacionit në fuqi, në përputhje me rregullat e kontabilitetit, si dhe të kenë përmbushur

detyrimet kontraktuale ndaj ofruesit të mbështetjes financiare dhe të gjithë ofruesve tjerë të mbështetjes financiare publike, të krijuara deri më 31.12.2021. (Në këtë pikë për këtë cikël të thirrje publike për projekt-propozimet kulturore 2022 përjashtohet mbështetja financiare publike në kuadër të Fondit të Ringjalljes për vitin 2021)

- OJQ-të nuk kanë të drejtë të aplikojnë me më shumë se 1 projekt-propozim në këtë thirrje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike “Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës” për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategoritë 1, 2, 3 dhe 4;
- Anëtarët e OJQ-ve aplikuese nuk kanë të drejtë të aplikojnë edhe si individ në këtë apo ndonjë kategori tjetër në kuadër të kësaj thirrjeje publike. Në këtë pikë mund të përbëjë përjashtim aplikimi në kategorinë 5 të kësaj thirrje publike “Fondi i mobilitetit për promovim ndërkombëtar të artit dhe trashëgimisë kulturore të Republikës së Kosovës” për aktivitete të cilat nuk janë pjesë e integruar e projekt-propozimeve të prezantuara për kategoritë 1, 2, 3 dhe 4;

Kriteret e veçanta për OJQ-të të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- OJQ-të e regjistruara në Republikën e Kosovës, të profilizuara në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore, me përvojë të dëshmuar në sektorin e kulturës, që plotësojnë kriteret përkatëse të përgjithshme dhe të veçanta;
- Të ofrojnë ftesën zyrtare apo letrën e pranimit për pjesëmarrje në ngjarjen përkatëse.

Kriteret e përgjithshme minimale për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Të ofrojnë dëshmi të regjistrimit civil në Republikën e Kosovës;
- Të kenë kryer të gjitha detyrimet nga mbështetja financiare paraprake, nëse kanë përfituar nga burimet publike të financimit;
- Të mos kenë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete;
- Të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës. Stafi i angazhuar për realizimin e aktiviteteve të projekt-propozimit të cilat do të gëzojnë mbështetjen financiare nga kjo thirrje nuk lejohet të jetë i punësuar në MKRS ose në institucione vartëse të saj;

Kriteret e veçanta për INDIVIDËT të përcaktuara me dispozitat në vijim:

- Profilet e përshtatshme të individëve për këtë kategori janë krijuesit artistik, performuesit artistik, profesionistët e trashëgimisë kulturore, studiues, hulumtues në fushën e artit dhe trashëgimisë kulturore;
- Të ofrojnë ftesën zyrtare apo letrën e pranimit për pjesëmarrje në ngjarjen përkatëse.

Periudha e zbatimit të projekt-propozimit:

Projekt-propozimet përfituese në këtë thirrje publike duhet të zbatohen në tërësi deri më 31.12.2022.

Shkalla e mbështetjes:

- Shuma maksimale e mbështetjes për një përfitues 8,000.00 Euro